

VENDIM
Nr. 87, datë 29.6.2012

**PËR RISHIKIMIN E TARIFËS SË FURNIZUESIT PUBLIK ME SHUMICË PËR PERIUDHËN
E TRETË RREGULLATORE 2012-2014, PËR AKOMODIMIN E EFEKTEVE FINANCIARE TË
VENDIMIT NR. 80, DATË 15.6.2012 TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S**

Në mbështetje të neneve 7, 8 pika 2 germa “b”, “ç” dhe “dh”, neni 26 pika 1 dhe 27 pika 1 germa “dh” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neni 16 pika 2 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, pikat 1.3 dhe 5.7 të modelit shqiptar të tregut të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 239, datë 19.3.2008 dhe neneve 112, 121 dhe 128 të Kodit të Procedurave Administrative, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.6.2012, pasi u njoh me relacionin e grupit të punës të ngritur për akomodimin e efekteve të Borxhit të Keq dhe qëndrimet e Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifën e furnizimit publik me shumicë për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014, në vlerën 2.2 lekë/kWh.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani